

JEPI VLERË TË ARDHMES TËNDE

2.0



KONTAKTE

CENTRO ANTIVIOLENZA DI PIACENZA
- Associazione La Città delle Donne O.d.v. -
0523.334833

Nga ora 9.30 deri në 17.30 - nga e hënë në të premte
centroantiviolenzapc.donne@gmail.com



SI TË HYSH TEK PËRMBAJTJA NËPËRMJËT KODIT QR

Hapni aplikacionin e integruar të kamerës në telefonin ose tabletin tuaj. Inkuadro kodin QR dhe prek banderolën që shfaqet në telefonin ose tabletin tënd, do të ridrejtohesh në faqen e internetit të treguar nga Kodi QR dhe/ose do të shikosh të gjithë informacionin që përmban kodi në fjalë.



5.

1. HAP FOTOKAMERËN E TELEFONIT TËND
2. INKUADRO KODIN QR
3. PREK BANDEROLËN
4. HYR TEK FAQET PDF
5. SHIKO TË GJITHË DOKUMENTIN



Të kesh një punë, të kultivosh ambicje profesionale, të menaxhosh personalisht kursimet e tua, si dhe të jesh pjesë e vetëdijshmë e zgjedhjeve të tua për sa u përket “parave”,
bën pjesë në të drejtat e patjetërsueshme të vetëvendosjes së një personi të cilën askush nuk duhet ta kundërshtojë.

6.



JEPI VLERË TË ARDHMES TËNDE

2.0

MENAXHIMI FINANCIAR
ËSHTË LIRI PËR GRATË



Progetti Div.E. - Divenire per Essere -
Del. R.E.R. 748 del 15.05.23

PREZANTIMI I PROJEKTIT

Ky projekt lind nga domosdoshmëria për të sjellë informacion që mund të përdoret për të qartësuar dhe thjeshtësuar, për të gjitha gratë, tema në dukje të vështira të cilat duken kaq të largëta nga përditshmëria jonë, por që përkundrazi rezultojnë të jenë vendimtare pikërisht sepse "menaxhimi i të pasurit " përkon me rezultatin e "të bërit". Nëpërmjet KODIT QR do të mundësohet hyrja në informacione të dobishme, këshilla, lidhje (link), shembuj praktikë dhe përkthime shumëgjuhëshe në mënyrë që çdo grua të mund të përipiqet t'i qaset menaxhimit të burimeve të saj ekonomike, pa bërë gabime që mund të ndikojnë në të ardhmen e saj.

ÇËSHTJA E PARAVE

I ka rrënjët në kulturë dhe shoqëri. Akoma sot, në shumë familje, administrimi i parave është një përgjegjësi e maskullit.

Menaxhimi i ndërgjegjshëm financiar vepron si një levë për përfshirjen sociale dhe mund të përfaqësojë një element të rëndësishëm të parandalimit kundër dhunës gjinore.

DHUNA EKONOMIKE prek afërsisht 25% të grave, madje arrin në 40% në disa rajone italiane.

1.

QELIMI I KETIJ UDHEZUESI

Sipas të dhënave të përpiluara nga Banka e Italisë, hendeuku gjinor në njohuritë financiare në vendin tonë është shumë më i theksuar se ndër shtetet e tjera të BE-së. Më shumë se 7 nga 10 herë është maskulli ai që merr vendimet financiare të çiftit.

Ky udhëzues do të jetë në gjendje të na ndihmojë të afrohemi me ndërgjegjësimin se menaxhimi i parave, njohja e kurtheve dhe/ose mundësive dhe/ose përfitimeve që mund të sjellë një "nënshkrim" dhe për rrjedhojë rëndësinë e njohjes së rreziqeve. Përveç kësaj ndërgjegjësimi për të drejtat e barabarta në vendin e punës janë thelbësore për të sjellë qëndrueshmëri në jetën tonë dhe për të parë drejt një të ardhmeje duke mbrojtur veten nga ngjarje të paparashikuara.

NDAJ KY UDHËZUES NA ËSHTË DEDIKUAR NE GRAVE

Një mjet që mund të na ndihmojë të forcojmë dhe rrisim vetëvlerësimin tonë kur shikojmë çështjet të cilat lidhen me "paratë" jo me sipërfaqësi, indiferencë apo frikë, por me përgjegjësi, interes dhe madje besim më të madh

2.

SI TË ZVOGËLOHET HENDEKU GJINOR NËPËRMJET EDUKIMIT FINANCIAR

Është thelbësore që gratë të ndërgjegjësohen më shumë për disa aspekte thelbësore duke u bërë të vetëdijshme për nocionet bazë të edukimit financiar, si:

- ▶ SI FUNKSIONON REGJIMI I PRONËSISE FAMILJARE
- ▶ TË DINË PËRDORIMIN E NJË LLOGARIE BANKARE
- ▶ TË NJOHIN TË DREJTAT E TRASHËGIMISË
- ▶ ZHVILLIMI I MARRËVESHJEVE TË BASHKËJETESËS PËR PERSONAT QË NUK JANË TË MARTUAR
- ▶ INFORMACION DHE PRAKTIKA PER BLERJE SHTEPIE
- ▶ SI TË FILLOJNE NJË BIZNES
- ▶ SI TË BËSH NJË TESTAMENT
- ▶ BARAZIA NË PUNË

Në territorin tonë ka profesionistë të disponueshëm për të sqaruar, mbështetur dhe këshilluar.

3.



Duke hyrë në kodin QR, do të gjeni një version përmbledhës të secilit prej tre takimeve të kursit të edukimit financiar të titulluar "Jepi vlerë të ardhmes tënde" organizuar në Dhomën e Këshillit të Provincës së Piacenzës në bashkëpunim me:

- BANCA D'ITALIA FILIALI I PIACENZËS
- CONSIGLIO NOTARILE I PIACENZËS
- PROVINCIA E PIACENZËS
- CONSIGLIERA DI PARITÀ PROVINCIA E PIACENZËS
- QENDRA ANTIVIOLENZA E PIACENZËS

gjithashtu lidhje (link) të thelluara si dhe udhëzime për aksesin e dëgjimin e regjistrimit të çdo takimi:



▶ **MENAXHIMI FAMILJAR**
Përmbledhje e takimit të dt. 9 Tetor 2023

▶ **SI TË MENAXHONI NJË TRASHËGIMI**
Përmbledhje e takimit të dt. 26 Tetor 2023



▶ **PUNA DHE NDËRMARRJA**
Përmbledhje e takimit të dt. 8 Nëntor 2023

4.

